



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INFORMIMIT PUBLIK
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2710 Prot.

Patos, më 08/10 2025

NJOFTIM

**Dëgjësë publike me temë:
“Prezantimi përfundimtar i Paketës Fiskale 2026”**

Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”.

Ju njoftojmë se:

- 1- Ditën e **Martë** në datë **07.10.2025 ora 09³⁰**, në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak do të organizohet takimi konsultativ me përfaqësues të: Anëtarë të Këshillit Bashkiak; kryetarë të fshatrave; banorë të zonës; biznese që operojnë në Patos; shoqëri civile; përfaqësues të bashkisë Patos dhe grupe të tjera interesi me temë: **“Prezantimi përfundimtar i Paketës Fiskale 2026”**.
- 2- Ditën e **Mërkurë** në datë **08.10.2025 ora 10⁰⁰**, në ambientet e njësisë administrative Zharrëz do të organizohet takimi konsultativ me përfaqësues të: anëtarë të Këshillit Bashkiak; kryetarë të fshatrave; grupe interesi; banorë të zonës; biznese që operojnë në njësinë Zharrëz; shoqëri civile; përfaqësues të bashkisë Patos dhe grupe të tjera interesi me temë: **“Prezantimi përfundimtar i Paketës Fiskale 2026”**.
- 3- Ditën e **Premte** në datë **10.10.2025 ora 10⁰⁰**, në ambientet e njësisë administrative Ruzhdie do të organizohet takimi konsultativ me përfaqësues të: anëtarë të Këshillit Bashkiak; kryetarë të fshatrave; grupe interesi; banorë të zonës; biznese që operojnë në njësinë Ruzhdie; shoqëri civile; përfaqësues të bashkisë Patos dhe grupe të tjera interesi me temë: **“Prezantimi përfundimtar i Paketës Fiskale 2026”**.

Këto konsultime publike synojnë realizimin e një procesi transparent mbi prezantimin e dokumentit final të Paketës Fiskale 2026 në të tre njësitë administrative të bashkisë Patos.

Komentet dhe rekomandimet e grupeve të interesit janë të mirëpritura, brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik në adresën e email-it: info@bashkiapatos.gov.al.

Pjesëmarrja juaj në këtë dëgjese publike është shumë e rëndësishme për garantimin e një procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.

KRYETARI
Fation Duro

